



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 16.09.2013
Nr. 0234-1204

PËR: Naim Ismajli, Kryetar i Komunës së Shtimes
Kujtim Xhelili, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes

LËNDA: KËRKESË PËR RISHQYRTIMIN E LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË SHTIMES, Nr. 01/183, të pranuar me datën 12.09.2013.

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin NR. 04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës. shtojcën XII të Rregullores së Qeverisë 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit nr. 01/183, të datës 30.08.2013, të Kuvendit të Komunës së Shtimes, konstaton se:


- Vendimi nr. 01/183, për ndarjen e 20 ari truall për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Lagja e Pajtit, është i kundërligjshëm, pasi të njëjtit i mungon baza ligjore e nxjerrjes së vendimit nga Kuvendi i Komunës, të përcaktuar me nenin 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale si dhe nenin 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
- Me rastin e dhënies në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale sipas vendimit nr. 01/183, nuk është përcaktuar afati kohor, ashtu siç parashihet me nenin 5 si dhe nenin 6, të Ligjit Nr. 04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Shtimes që të ndër marrin veprime konkrete që, Vendimi nr. 01/183, Kuvendit të Komunës së Shtimes, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës të bëjë rishqyrtimin e aktit.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve dhe MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 16.09.2013

Br. 0234-1204

Za: Naim Ismajli, Gradonačelnik Opštine Štimlje
Kujtim Xhelili, Predsedavajući Skupštine Opštine Štimlje

**PREDMET: ZAHTEV ZA PONOVRNO RAZMATRANJE ZAKONITOSTI ODLUKE
OPŠTINE ŠTIMLJE, Br. 01/183, primljeno dana 12.09.2013.**

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu za Lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, Zakon br. 04/L-144 za Davanje ne korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke br. 01/183, od dana 30.08.2013, **Skupštine Opštine Štimlje**, konstatuje:

- Odluka br. 01/183, za dodelu 20 ari placa za izgradnju Džamije u selu Lagja e Pajtimit, donet od Škupštine Opštine Štimlje, je protivzakonita, pošto istoj nedostaje zakonska osnova koja treba da bude u skladu sa Zakonom Br. 04/L-144 za Davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine.
- Takodje prilikom davanja na korišćenje nepokretne opštinske imovine prema odluci br. 01/183, nije određen vremenski rok za davanje na korišćenje nepokretne opštinske imovine u skladu sa članom 5 i članom 6, Br. 04/L-144 za Davanje na korišćenje i razmenu nepokretne opštinske imovine.

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu člana 82 tačka 2 Zakona za lokalnu samoupravu *traži* Skupštine Opštine/Gradonačelnika Opštine Štimlje da preduzme konkretne mere, da Odluka br. 01/183, Skupštine Opštine Štimlje, u roku od 30 dana od dana prijema zahteva da se izvrši razmatranje akta.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanik Premijera & Ministar MALS,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima uprava i kancelarija
Arhivu MALS-a



Npi – 01/183, Datë: 30.08.2013

Kuvendi Komunal – Shtime shqyrtoi kërkesën, 01Nr.016/2575, datë:23.05.2013 të Imamit të Xhamisë së vjetër në Shtime z.Isa Tërshani, i cili në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, dega në Shtime, ka paraqitur kërkesë me të cilën ka kërkuar që Kuvendi Komunal, të ndajë një Lokacion prej 20 ari sipërfaqe, në Lagjen e Pajtimit, për ndërtimin e një Xhamie për besimtarët e këtij lokaliteti i cili sipas regjistrimit të fundit ka rreth 216 shtëpi me 1553 banorë. Propozojmë që lokacioni të jetë në mes të fshatit në një vend të përshtatshëm. Jemi të mendimit se 20 ari i plotësojnë nevojat për Xhami dhe objektet përcjellëse.

Kuvendi Komunal-Shtime, pasi analizoi kërkesën e palës, Rekomandimet e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, mori këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E 20 ARI TRUALL PËR NDËRTIMIN E XHAMISË NË FSHATIN LAGJA E PAJTIMIT

I

Kuvendi Komunal – Shtime, në mbledhjen e shtatë, të rregullt për vitin 2013, të mbajtur më datën 30.08.2013, unanimisht ka vendosur që të aprovoi kërkesën me numër 01Nr.016/2575, të Bashkësisë Islame të Kosovës, dega në Shtime të paraqitur nga Imami z.Isa Tërshani, dhe i ndanë 20 (njëzet) ari truall për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Lagja e Pajtimit, në pjesën e ngastrës kadastrale me numër 211. Z.K.-Petroviq (Lagje e Pajtimit), Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal – Shtime.

II

Kërkesa është aprovuar duke u bazuar në rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe të Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi.

III

Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, është e obliguar që të kryej procedurat tjera administrative dhe Ligjore për implementimin e këtij vendimi.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtoris për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.



Kryesuesi Kuvendit
Kujtim Xhelili